



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 258

Datë: 25.05.2023

PROCESVERBAL

I mbledhjes së -III- (tretë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës.

REND I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt, datë: 28.02.2023.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar të Kryetarit për vitin 2022.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për orar të punës së subjekteve afariste.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transportin publik urban.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2023.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të luftës për vitin 2023.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/11 datë: 10.01.2022, e parashtruar nga Jetmire Vrenezi dhe Gani Krasniqi, Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- 8.Shfuqizimi i vendimit nr.02/71 datë:07.02.2023, për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja.
- 9.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/425 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës së Malishevës.
- 10.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/81 datë:10.02.2023.
- 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/09 datë: 06.02.2023.
- 12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/35 datë: 19.01.2023.
- 13.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/20 datë:11.01.2023.
- 14.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 30.03.2023 dhe filloi në ora:10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 26 asambleistë,drejtorë komunal, përfaqësues nga Kfori Zvicëran dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Malishevës. Të pranishëm jemi 26

anëtarë të kuvendit kemi korum dhe mund të vazhdojmë punimet e seancës, Para se të fillojmë me rendin e ditës i kemi në dispozicion 30 min për debat jashtë rendit të ditës.

Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë vetëm dëshirova të ndaj me ju atë që jeni të veshur me petkun e përgjegjësive si përfaqësues të qytetarëve. Një ngjarje e tmerrshme që ka ndodhur në fshatin Banjë për të dytën herë radhazi. Kjo ngjarje e tmerrshme ka të bëjë me një aksident, ku ditë më parë në cilësinë e përfaqësuesit të qytetarëve në Komunën e Malishevës, vizitova nga afër marketin në fshatin Banjë ku ndodhi aksidenti i tmerrshëm. Këto ditë, në këtë market që gjindet afër postës dhe përballë shkollës fillore të mesme të ulët "Naim Frashëri" të fshatit Banjë të Malishevës, një vetur e cila po vinte me shpejtësi të madhe, ku si pasojë e vozitjes së shpejtë ka përfunduar në marketin e një fjalë. Sipas familjarëve është hera e dytë që kjo është ripërsëritur dhe ata presin nga institucionet përgjegjëse që në këtë pjesë të intervenohet dhe të mbrohet që aksidentet fatale mos të përfundojnë në të tilla forma. Pas këtij aksidenti të tmerrshëm ka përfunduar në spital shitësi i marketit ku është në gjendje jo të mirë shëndetësore, duke përfunduar me lëndime të rënda trupore. Ajo qka po kërkoj nga të gjithë ne që jemi përfaqësues të qytetarëve në një formë të meren masa të menjëherëshme nga institucionet përkatëse, sepse rrezikshmëria është shumë e lartë. Të tilla raste urojmë që të mos ketë në Komunën e Malishevës, por dhe në të tilla rrugë ku rreziku është lartë institucionet përkatëse urgjentisht t'i vizitojnë dhe të marrin masa parandaluese.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: I nderuari kryetar, asambleist, drejtor, përfaqësues të mediave, KFOR-I Zvicrran! Pasi që jemi jashtë rendit të ditës, unë do t'ngjirsdisa qëshetje në interes të qytetarëve. Së pari sa seanca radhazi që unë dhe kolegët tonë ngrisum problemin për qenët endacak, është mirë me u marrë dhe një herë me këtë punë, sepse ka shumë raste dhe shpresojmë të mos shkojmë te fatalitetet. Renovimi i rrugëve lokale- më intereson të di kur do të fillojë mbulesa e gropave në rrugë, ku do që shkon në fshatra gropat në rrugë janë të hapura, asfalti pa asnjë kriter, është mirë të dilni në teren. Po e marrë specifikisht rrugën e Senikut, duke filluar nga shitorja dhe deri ta kalon pompën është tmerr ajo rrugë. Drejtori i shëndetësisë, përse nuk është në asnjë senacë që ne e mbajmë, kemi qëshetje për të ngritur dhe ai nuk është prezent.

Qëshjtja tjetër është sinjalistika rrugore me fokus të veçantë në Banjë dhe mbarë fshatrave në Komunën e Malishevës, nuk kemi një tabel rrugore që tregon fshatin, nuk kemi ende numra të shtëpive të vendosur, mirë është me u marrë Kryetar me këtë qëshjtje. Rruga që lidhë Senikin me Banjë ka qenë një tabel që ka qenë te komparativa aty, ajo tabel nuk ekziston më dhe aty kemi pasur një rast me fatalitet. I ftoj ekipin e inspektoriatit që të dalin në këtë rrugë dhe të shikojnë gjendjen aty se ku është tabela, sepse gjatë punimeve të autostradës ajo tabel nuk gjindet më aty.

Kryesues, qëshjtje tjetër është kjo kamera në mes, a është duke bërë apo jo, duhet me na plotësu kushtet sepse për këtë arsye je Kryesues i Kuvendit, Këto ishin disa qëshjtje të cilat i ngritëm në interes të qytetarit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përshëndetje Kryetar, përshëndetje për të gjithë!

Qëshjtja e parë ka të bëjë me projektin e sheshit të dëshmorëve që ka fillu, dhe përmes shkresës ju kam drejtuar dhe Drejtorit të Urbanizmit dhe Drejtoris për Kadastër, përgjigjia nuk ka qenë e qartë për mua. Unë specifikisht kam kërkuar nga kadastër që parku i qytetit është pronë komunale apo pronë e APK-së ndërsa përgjigjia ka qenë për rrugën "Ibrahim Mazreku" që është pronë e Komunës. Nuk kam marrë një përgjigjje të saktë, dua të di qoftë nga Drejtori Bashkim apo nga Kryetari a është pronë Komunale apo e APK-së, sepse nëse është pronë e APK-së është një procedurë tjetër.

Faleminderit Drejtorit Avdi Morina, sepse më ka ftuar në zyre që të shoh dokumentet e rrugës por nuk kam mundur të shkoj për arsye të angazhimeve të mia, nëse kishe mundur ato sqarime me i dhënë sot lidhur me punimet e rrugës "Ibrahim Mazreku". Me sa kam parë nga dy apo tri vizitave që i kam bërë punimeve, projekti ndryshon prej fazës fillestare që ka fillu prej urës e deri te objekti i KEDS-it ose me

Gjimnazin. Pjesa e parë ka qenë e zhvilluar me punime përmes kanalev, ndërsa në anën tjetër kam parë që faza e dytë që ka fillu ka vazhdu me gypa më të ngusht të betonit. A ka ndryshime të kontratës apo pse ka ndodhë?

E kam mbështet publikisht aksionin e Komunës për lirimin e hapsirave publike, vetëm dua të di a ka me vazhdu dhe në pjesë të tjera të Komunës dhe mos me qenë vetëm në linjën e rrugës "Ibrahim Mazreku". Po ashtu dua të di a ka pasur selektim?

Sa i përket qështjes së shëndetsisë nuk është Drejtori, por ndoshta Kryetari mundet me na dhënë përgjigjie e para për qështjen e Mamografis, disa pacient që më kanë kontaktuar aty po vazhdon me u kry si shërbim, por ka radhë të gjatë të pritjes, para tri vitesh një grua ka shkuar për ekzaminim dhe ka thënë që duhet me prit deri në muajin nëntor, është absurde nëse ajo ka shqetësime shëndetsore dhe i duhet të pres deri në muajin nëntor. Nëse është aparati, është specialisti, dhe është stafi përse nuk zhvillohen me kapacitete më të mëdhaja dhe me punu mos me pas pritje.

Dhe një qështje të fundit për dezinfektimin e rriqërave, a ka fillu Komuna me i bërë përgaditjet apo Drejtoria e Shëndetsisë, sepse herën e kaluar ka filluar shumë me vones, fatmirësisht nuk kemi pasur raste por në këtë vit nuk kemi pasur reshje dhe dimri e dimë se si ka qenë dhe mundemi me pas më shumë probleme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përsëndetje Kryetar, Drejtor, dhe të gjithë ju koleg asambleist!

Unë dua t'i ngris disa qështje të cilat kanë të bëjnë me Drejtorin e Urbanizmit. E kam ngritur si qështje disa herë problemet e shumë banorëve të cilët i kanë me kanalizimet. Gjendja e kanalizimeve në fshatin Kijevë është tmerrësisht e keqe, sepse në fshatin Stapanic rrjedhin ujrat e zeza, mandej dhe gjatë fushatës të cilët kanë bërë ka figuru rregullimi i kanalizimit në fshatin Kijevë, por ende nuk është marrë ndonjë hap. gjendja është shumë më e keqe se sa ka qenë.

Qështja tjetër është ndriqimi publik, e keni një kontrat për ndriqimin publik, shumica e fshatrave edhe aty ku është bërë ndriqimi publik është jashtë funksionit. Konkretisht po flas për fshatin Kijevë, që nga viti 2015 kanë qenë rrugët e buxhetuara për ndriqim publik, por ende nuk kanë ndriqim publik. Ndoshta jeni në dijeni që kohët e fundit kanë ndodhur dhe disa plaqkitje, ndriqimi është një prej arsyeve, Po ashtu mungon dhe siguria, ka munges të një stacioni policor. Mandej e kemi pa qështjen e donacionit që është bërë renovimi i disa shkollave, njëra prej tyre është dhe shkolla jonë më në fund. Kisha bërë thirrje me i monitoru këto punime që bëhen nëpër këto shkolla, sepse ato nevojën elementare që i kanë pasur objektet ekzistuese ka qenë problemi me izolim. Shkolla ku punojë unë më emergjente e ka pasur që të bëhet izolimi i kulmit sesa ndërrimin e dritareve. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Kryetar!

Ekrem Kastrati: Përsëndetje për të gjithë!

Po e dhuroni maksimumin që qytetarët e Komunës së Malishevës të meritojnë një qevërisje pak më cilësore dhe më përmbajtësore në zhvillimin e saj. Rruga për Banjë që është bërë një aksident trafiku, dua të sqaroj që kjo rrugë është në mbikqyrje të biznesit të transportit dhe infrastrukturës nga qeveria e Kosovës dhe çdo përpjekje e jona është e pamundur. Ne kemi kërkuar nga Ministri që të na ndihmojnë me ndërtu një nën kalim aty, por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigjie. Ngjajshëm kemi rrugë të tjera që frekuentohen nga fëmijët dhe kalimtarët të rastit, mirëpo nganjëherë po mungon vetëdija qytetare që të ulin shpejtësin e automjetit. Sigurisht ne me përfaqësuesit e PSB-së i kemi diskutuar këto qështje dhe po përpiqemi që pikat e zeza ku i kemi ti rregullojmë sa më shpejt dhe me organe të tjera të qeveris në këtë rast me Policin e Kosovës.

Lidhur me qentë endacak, sigurisht që është një problem që na preukupon të gjithëve kemi pritur nga qeveria e Kosovës që ta merr një hap më përmbajtësor për me lubu për këtë dukuri në nivel vendi por ende qeveri nuk ka bërë ndonjë hap. Ne me Drejtorin e Bujqësis jemi dakorduar që ta iniciojmë një procedurë e cila ka të bëjë me pastrimin e qenëve endacak, por ta shohim se si do të shkoj kjo procedurë më tutje. Ne do të bëjmë përpjekje maksimale që të ulim numrin e qenëve endacak të cilët janë me

sëmundje.

Riparimin e rrugëve në gjithë territorin e Komunës tonë sigurisht e kemi një kontrat dhe në pranver operatori jonë ekonomik kemi kërkuar që sa më shpejt ta bëjmë riparimin e rrugëve në Komunën tonë, mirëpo sipas të dhënave të cilat i kemi deri ka mesi i prillit, fabrikat të cilat prodhojnë asfalt nuk janë në funksion dhe ne presim që këto fabrika të hynë në funksion dhe të vazhdojmë punën tonë. Drejtori i shëndetësis aktualisht është në spital për arsye të gjendjes jo të mirë të djalit të tij, urojmë që djali i tij sa më shpejt të shërohet.

Sa i përket qështjes së mamografisë, sigurisht do ta keni rastin që Drejtori të vij këtu dhe të i jep sqarimet e tij, por sistemi shëndetësor në Komunën tonë dallon prej komunave të tjera të cilat dhurojnë shërbime të tilla shëndetsore.

Sinjalizimi i rrugëve lidhur me tabela ne e kemi krijuar një kontrat që ka të bëjë me vendosjen e shejave të komunikacionit, përkatësisht për shejat të cilat udhëzojnë pjesëmarrësit në trafik që të shkojnë deri në destinacionin e caktuar. Dua të cekim që qytetarët me vetëdije po i shkatërrojnë në masë të madhe këto shenja, dhe kisha kërkuar nga ju asambleistë që të ju tregojmë qytetarëve për rëndësinë e këtyre shenjave që mos të i dëmtojnë. Numrat e shtëpive ka qenë një projekt i fondacionit dhe tani na jep drejtori i urbanizmit ndonjë informacion për këtë qështje.

Sheshi është pronë e Komunës dhe nuk kemi pasur nevojë që ta trajtojmë si pronë të AKP-së.

Lirimi i hapsirave publike sigurisht që ka qenë një sfidë për shërbimet Komunale dhe për gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, por ky vendim ka qenë i domosdoshëm sepse hapsirat publike në komunën tonë kanë qenë dhe janë të ozupuara për dallim në nga komunat e tjera, sepse unë kam vazhdimisht kontakt me kryetarët e komunave të tjera dhe kam parë që Komuna e Malishevës është njëra prej komunave e cila ka përqindjen e ozupimit më të madhe. Të gjithë operatorët apo pronarët e shtëpive dhe lokaleve të cilët janë në hapsira publike, ne do të bëjmë maksimumin që gjithsecili të lirojë pasi që kjo pronë është e komunës dhe secili është i vetëdijshëm për këtë vendim. Nuk ka pasur selektim as tolerancë dhe as dallim dhe nuk do të ketë.

Ndriqimi publik ne po bëjmë përpjekje maksimale që të vazhdojmë ndriqimin publik por njëkohësisht të ulim shpenzimet.

Fondi për efqencë sigurisht që do të përcjellet me mbikqyrjen tonë, dhe pse me kontratë fondi për efqencë nuk e obligon Komunën të jetë mbikqyrëse dhe as neve nuk na pyet askush se sa punë po përfundohet.

Me kanë ardhë dhe disa pyetje të tjera siq është: Cila është arsyeja që po kërkohet të largohet shtatorja e Adem Jasharit dhe të zëvendësohet me një tjetër? Askush në këtë Komunë nuk e ka për qëllim ta largojë shtatoren e Adem Jasharit. E konstatojmë që zhvendosja mundet me qenë vetëm deri në oborrin e Komunës deri sa të përfundojnë punimet, por sheshi pa shtatore të Adem Jasharit nuk ka me qenë kurr. Malisheva urbane ka plan urbanistik, sigurisht jeni të profilizuar profesionalisht deri në atë masë që e dini se çka është plani urbanistik dhe çka është urbanizmi. Anulimi i projekteve në fshatra në Komunën e Malishevës, nuk është anulim por më shumë jemi fokusuar në qenë që ta rregullojmë sa më shpejt që është e mundur.

Disa pretendime që disa qytetarë kanë thënë që në sheshin e dëshmorëve gjinden disa eshtra të civilëve jo të vrar, por nga vdekja natyrale, edhe këtu i kemi pasur do shqetësime. Kemi pasur takime të vazhdueshme me këta qytetarë, kemi biseduar se si të ja bëjmë këti fenomeni dhe kemi arritë pajtueshmëri me ta. Këto eshtra do të trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme më një rrezore, më dinjitoze, dhe do të rivarrosen në vendin ku vetë qytetarët kanë kërkuar.

Këto ish disa shqetësime të cilat i kemi ngritë faleminderit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtori i Urbanizmit Avdi Morina!

Avdi Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit shumë për të gjitha pyetjet të cilat i bëtë. Te disa pyetje Kryetari i dha përgjigjet, numrat e shtëpive ne kemi pasur një kontratë me agjencionin kadastral dhe në vitin e kaluar në disa fshatra janë vendosur numrat e objekteve apo shtëpive të banimit. Këtë vit pritet të përfundojnë të gjitha fshatrat me vendosjen e numrave të shtëpive, sepse po mbështetet nga banka botrore, Komuna e Malishevës dhe agjensioni kadastral.

Një shqetësim tjetër që ke nga Labinoti për qështjen e rrjetit të kanalizimeve, Kryetari dha përgjigje që është angazhuar me Kryetarin e Komunës së Klinës për një zgjidhje të përbashkët. Janë disa projekte që mundësohet Komunave në partneritet për zgjidhjen e përhershme të atij fenomeni. Një pjesë e kanalizimeve e cila kalon prej fshatit Pllloqicë, Mleqan dhe Kijevë normalisht duhet me pas implementimin sepse nuk është i përfunduar.

Një pyetje tjetër rreth kanalit të ujrave atmosferike në rrugën "Ibrahim Mazreku" nga asambleisti Veton Zogaj, Veton ke bërë kërkesë zyrtare për të pasur qasje në dokumentet dhe projektet tona për arsye të madhësis së projektit, sepse projekti i sheshit përbëhet prej 30 librave të cilët i kanë nga 300 apo 500 faqe. Është e pamundur që ta bëjmë kopje mirëpo ju ftojë gjithsecilin prej jush që keni dëshirë me pa dhe me dhënë kontributin e juaj jeni të mirëseardhur. Sa i përket rrjedhjeve të ujrave atmosferike ajo pjesë ka pasur të përfundoj me gypa 1800, por për arsye të rëndësishme që ka pasur kjo zonë nga ura deri te rruga për te emergjenca ne për arsye të pozicioneve që i kemi pasur të mundshme për ti lëvizur kemi kërkuar që të mos vendoset gyp por të vendoset një kanal, sepse nëse ndodh që të bllokohet njerzit mund të hyjnë ta pastrojnë.

Një kohësisht kemi probleme sa i përket rrjetit të kanalizimeve, mirëpo shumica e investimeve me qenë se janë adresuar në projekte të mëdha në qendren e Malishevës, po është e pamundur në aspektin financiar për ti filluar por në suficien siq jemi ne kemi filluar dhe rregullimin e kolektorit kryesor i cili fillon nga fshati Bubël dhe vjen deri në fshatin Lumisht.

Sa i përket projekteve për efikasitet, ne i kemi sjellë gjashtë projekte kapitale të cilat normalisht janë duke u zhvilluar. Është përfunduar gjimnazi "Hamdi Berisha", është përfunduar shtëpia e kulturës, një kohësisht kemi filluar dhe projektin te salla e sportit "Habib Zogaj" e cila dhe ajo është duke u përfunduar si projekt, shkolla fillore e mesme e ulët "Ibrahim Mazreku", shkolla "Labinot Krasniqi" Mirushë, dhe gjimnazi në Kijevë e cila dhe kjo është pjesë e projektit. Mirëpo te qështja e mbikqyrjes Labinot po pajtohna dhe unë dhe pse ne nuk kemi të drejt, së bashku me zyrtarët tanë kemi shkuar dhe i kemi dhënë vërejtje. Në takimin e fundit të cilin e kemi pasur me zv.ministrin, ne kemi kërkuar që të kemi mbikqyrësin, sepse na ka ndodhë psh. Te shtëpia e kulturës pas vërejtjeve që kemi dhënë e kemi detyruar që të tërhiqet kamera e cila është vendos dhe është vendosur materiali i mirë.

Një problem që po ballafaqohemi sa i përket aspektit urban si qytet, po fillojmë prej faktit se si komunë edhe pse e kemi një plan zhvillimor i cili është votuar në vitin 2019, pas një përpjekje të gjatë që të shkojmë me harta zonale shpesh herë jemi vonuar. Kryetari ka kontaktuar me Drejtorin e mjedisit dhe bashkarisht e kemi takuar zv.Ministrin pas presionit kemi arritur në lëvizje pozitive, mirëpo po presim përgjigjen e fundit që të aprovohet për të dalë në dëgjime publike. Në momentin që harta zonale votohet në kuvend menjëherë fillojnë procedurat për katër zonat mbrenda qytetit për të bërë plane rregulluese mbrenda qytetit sepse është në interes të përbashkët. Faleminderit.

Argjend Thaçi: Faleminderit Drejtor!

Nëse nuk ka dikush për debat jashtë rendit të ditës, kalojmë te rendi i ditës. A ka ndonjë për të shtuar te rendi i ditës?

Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Faleminderit Kryesues!

Te pika e 3 e Rregullores për subjekte afariste nuk i kemi futur fare propozimet tona të cilat i kemi dërguar, kërkojm që kjo pikë të largohet prapë prej rendit të ditës dhe në vend të kësaj pikës të vendoset pika e 7.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Kërkoj që të futet si pikë e re zëvendësimi i anëtarit të Komitetit të Urbanizmit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Kërkojmë që të bëhet zëvendësimi i anëtarit të komitetit të diasporës për arsye se personi që ka qenë në emër të grupit të LVV dhe partisë Guxo është bërë pjesë e një subjekti tjetër politik.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!
Kryesues, unë e kam marrë një premtim publik që në seancën e ardhshme do të na sjellësh planin e punës së zyrës së prokurorit, por nuk është prapë. Ky është obligim ligjor me na sjellë atë Plan, më së largëti është muaji shkurt që duhet të vijë.

Argjend Thaçi: Ne Planin e punës së Prokurimit në Planin e Kuvendit e kemi në muajin prill.
Propozimi i parë ishte i Vetonit, që pika e 3.Rregullorja për orar të punës për subjekte afariste të shtyhet.
Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Sa i përket propozimit që pika e 3 të shtyhet, edhe ne jemi të shtyhet për seancën e radhës.
Të largohet kjo pikë prej rendit të ditës dhe pikat e tjera të jenë siq janë të renditura.

Argjend Thaçi: Pasi që është hera e tretë që kjo pikë po shtyhet, ju ftoj shifat e grupeve të secilit subject politik që me datën: 03.04.2023 në ora 10:00 të jenë prezent dhe t'i japim epilog kësaj qështje. Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Edhe ne jemi pro, që kjo pikë të shtyhet, po ashtu pajtohem me kërkesen tënde që të mbledhemi dhe të i japim epilog kësaj qështje sa më shpejt.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim propozimin e Vetonit, që pika e tretë të shtyhet, kush është për?

Për: 24

Kundër: 2

Abstenim: 0

Me 24 vota për, 2- Kundër, 0-abstenime shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojm me propozimin e radhës i cili është që pika e 7 të vendoset në vend të pikës 3 e cila u shty për mbledhjen e ardhshme. Kush është për?

Për: 9

Kundër: 16

abstenim: 0

Me 9 vota për, 16- kundër, 0- abstenime, nuk kalon ky propozim.

Vazhdojm me propozimin e Arlind Morinës: Zëvendësimi i anëtarit të komitetit të urbanizmit. Kush është që kjo pikë të hyjë si pikë në rend të ditës?

Për:

21

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 21 vota për, 2-abstenime ky propozim hynë si pikë në rend të ditës.

Propozimi i Valon Krasniqit është zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për diaspor të hyjë si pikë në rend të ditës. Kush është për? Unanimisht hynë si pikë e rendit të ditës.

Atëherë i hedhim si tërësi ndryshimet e bëra kush është për këtë rend të ditës?

Për: 25

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 25 vota për, 3- abstenime, 0-Kundër miratohet rendi i ditës.

Kalojmë te pika e parë që është: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë të rregullt datë: 28.02.2023. a ka dikush vërejtje apo sygjerim, ndonjë gjë që nuk është shënuar dhe që e keni cekur në mbledhjen e kaluar. Kush është për miratimin e procesverbalit? Unanimisht, miratohet procesverbali.

Kalojmë te pika e dytë e kemi një gabim teknik të vogël të cilën shënon Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin 2022, duhet të shenohet vetëm shqyrtimi i raportit sepse nuk kemi nevojë për miratim. Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

E falenderoj Kryetarin e Komunës sepse na ka përkrahë që të jetë e mundshme realizimi në shkallën e kënaqshme të buxhetit të vitit 2022, po ashtu dhe ju asambleist dhe Drejtor të cilën së bashku me ju e kemi bërë realizimin dhe implementimin e këtij buxheti.

Për vitin fiskal 2022 për periudhën Janar-Dhjetor buxheti është elaboruar nga ju me shumën 15,655,757.00E për të gjitha programet dhe nën programet. Kësaj i shtohen bartjet e disa shumave të vogla të donacioneve të mbetura nga vitet e kaluara në shumën prej 1,140.35E të regjistruara në SIMFK, del se shuma totale e buxhetit është 15,656,897.35E. Kësaj shume i shtohen dhe shumat prej 640,429.28E nga të hyrat e bartura nga viti 2021, fin.

Nga huamarrjet për paga në shëndetsi 92,883.00E dhe rritja e buxhetit për paga në arsim për mbulimin e vendimeve gjyqësore për 367,711.25E, del se buxheti i tërsishëm i futur në SIMFK si buxhet aktual përfundimtar kap shumën prej 16,757,920.88E.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë Janar-Dhjetor 2022, kap shumën prej 16,749,384.69E qka do të thotë se shkalla e realizimit është 99.95%.

Sipas shënimeve në librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 99.74%.

Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është 99.68%. Sipas buxhetit për vitin fiskal 2022, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen 1,033,469.00E.

Plan i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën janar-dhjetor 2022, të hyrat e rregullta janë 914,297.11E. Këto të hyra janë të futura në system, kurse janë të alokuara shuma prej 1,033,469.00E, pra aq sa janë të planifikuara, kurse gjobat në trafik për janar-dhjetor kapin shumën 350,001.00E.

Kurse gjobat e gjykatave në këtë periudhë janë 51,580.00E.

Gjithashtu të hyrat nga agjensioni pyjor i Kosovës për këtë periudhë janë 21.60E. Pra të hyrat e gjithëmbarshme, vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën prej 1,315,899.71E. Pra sipas shënimeve aktuale, në këtë periudhë janar-dhjetor 2022, % e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është 127.33%. Pra kemi një tejkalim prej 27.33%.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Kryesus, para se të fillojë me raportin, dua të cek një vendim që nuk e ke sjellë për shfuqizim lidhur me listën e pronave, dhe faleminderit prej grupit të NISMËS që në pikën më minimale që duhet një bashkëpunim me mirëkuptim zgjedhën mos bashkëpunim.

Te Raporti i kam cek dhe në K.P.F të dy tabelat që kam gjetur disa qështje të cilat nuk më janë përputhur me një paragraf në raportin aktual për vitin 2022. Pra të hyrat vetanake në mënyrë analitike ku specifikohen, është mirë me na i dhënë përgjigjet profa në vijim. Për vitin 2022 te kategoria qertifikata e lindjes janë rrit 200.00E, më është dukur shumë minimale, në raport me kërkesat e qytetarëve që janë për qertifikata.

Gjobat nga inspektoriati, unë jam kritik në këtë digaster, sepse i ka vetëm 2,698.92E të hyrat nga kjo kategori, ka shkelje nga subjektet afariste dhe operatorët të ndryshëm që meritojnë me u gjobit dhe pastaj rezultojnë me të hyra vetanake.

Qiraja për objekte është 9,027.00E, 0 ka qenë në vitin paraprak, pra nuk e di se cilat objekte i kemi me qira është mirë me na tregu.

Të hyrat nga viti i kaluar është 3,800.00E, qfarë është kjo?

Pastaj i kemi taksa për parkim publik, kjo shumë nuk përkon me realitetin, sepse ai ka qenë çdo herë i mbushur.

Shfrytëzimi i pronës publike shuma është 25,423.46E qfarë nënkupton ky shfrytëzim, sepse përveç shfrytëzimit të pishinës së bajës që është pronë publike të tjerat nuk e di cilat janë.

Liceca tjera afariste na kanë dhënë sqarime që nuk ka pasur kërkesa për liqencim nga subjektet afariste.

Taksa për legalizim të objekteve është 0, kjo don trajtim përse është zero. A ka qytetarë që aplikojnë për legalizim të objekteve dhe sa është taksa që i vendosim?

Inspektimi higjienik sanitar 250.00E, është e pa kuptimshme, sepse sidomos objektet publike kemi vërejtje të mëdhaja.

Të hyrat nga agjencioni pyjor është vetëm 21.60E edhe pse kemi dëmtime të pyjeve prapë e kemi këtë shumë.

Po kaloj te shpenzimi për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike janar-dhjetor 2022.

Shpenzime për udhëtim mbrenda vendit prej 1,044.20 është rrit në 3,033.40E.

Shpenzimet për internet prej 6,416.66 është rrit në 9,137.06.

Shërbime të ndryshme intelektuale në vitin e kaluar ka qenë 9,580.00E, ndërsa tani është rrit në 35,680.00E.

Shërbime teknike është 11,543.00E ndërsa ka qenë 1,143.50E pra është rrit për 10 fish më shumë.

Shpenzimet për anëtarësim prej 3,000.00E që ka qenë në vitin 2021 është rrit në shumën 18,500.00E.

Kompjuter me pak se 1000E në vitin 2021 ka qenë shuma 13,065.00E është ngrit 18,649.00E është më e lartë se sa heren e kaluar.

Furnizim i zyreve tani është 51,245.58E, ndërsa në vitin 2021 ka qenë 29,583.56E.

Furnizim për pastrim në vitin 2021 ka qenë 14,743.85E ndërsa tani është 21,691.48E.

Vaj për qfarë vaji bëhet fjalë në vitin 2021 0 ka qenë, ndërsa tani është 1,429.40E.

Dru pak a shumë ka ndiku dhe ngritja e qmimeve dhe ndoshta është relevant ky qmimi që është cekur këtu.

Karburant për vetura kemi dyfishim 77,939.09E në krahasim me vitin e kaluar që ka qenë 35,088.87E.

Mirëmbajtja e ndërtesave është 197,918.87E, ndërsa në vitin 2021 ka qenë 65,582.67E.

Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve 79,367.96E, ndërsa në vitin 2021 4,802.50E.

Shpenzime për informim këtë vit janë 1,248.00E, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 270.00E.

Drekat zyrtare këtë vit është 20,607.50E, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 9,795.30E, ndoshta është mirë me i pas sqarimet se përse kanë ndodhë këto.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valjeta Hoti!

Valjeta Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Nuk po i cekim me shuma vetëm me emra, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, shpenzimet për internet, shërbime të ndryshme intel. shërbime teknike, shpenzime për antarsim, furnizime për zyre, furnizim pastrimi, furnizim me veshëmbathje nëse kishe mujt me na dhënë një sqarim për qfarë veshëmbathje, karburant për vetura, mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve, dhe dreka zyrtare. Kërkoj sqarime për këto që i ceka.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit Drejtor i financave për elaborimin e raportit. Suksesi i një qeverie matet se sa e ka shfrytëzuar buxhetin. Qështja e parë që dua ta cekim është shpenzimi i buxhetit është i shfrytëzuar afër 99% e buxhetit kjo nënkupton që asnjë taksë e qytetarëve të Komunës nuk është shkuar në suficid por është shti në punë. Lajmi tjetër i mirë në këtë raport është që të hyrat janë tejkalu krahasuar me parashikimin për 27.33%. Janë dy qështje që tregojnë punën e mirë të qeveris për viti që lamë pas. U cekë që në shumicën e kategorive ka shpenzim më të madhë krahasuar me vitin e kaluar, parafolisit e cekën regjistrimin e

automjeteve qfarë lloj keqpërdorimi mundet me pas këtu, është rritë sigurimi për këtë arsye. Veton, 99% të rasteve ne të kemi mirëkuptu, e atëherë kur t'i e ke pas mundësin që ke mundur me kuptu dikan ti e ke përdor, kështuqë mos prit mirëkuptim prej dikuj që t'i nuk je i gatshëm me i dhënë asnjëherë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Halili e ceki që sukcesi i qeveris matet me atë që i shpenzon parat, unë mendoj që sukcesi matet me mënyrë se si i menaxhon parat, jo vetëm si i shpenzon parat. Unë kërkova mirëkuptim për një qështje, sepse nuk ka rëndësi a është e para apo e treta. Ndërsa për qështje të tjera pres përgjigje profesionale me na i dhënë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Para se të ja filloj analizimin e raportit, së pari deshta ta ceki një shqetësim të një shfuqizimi të një vendimi për prona, është obligative nga ana e juaj çdo vendim që vjen nga ministria për shfuqizim duhet të sjellet në kuvend të shfuqizohet, sepse tani mos po bimë ndesh me ligjin. Në të njëjtën kohë deshta të ndërlihem te raporti, i bashkangjitem dhe unë parafolësve, buxheti është në rregull me u shpenzu, është fakt që këtë vit është shpenzu, sepse çdo vit kemi pasur suficid të buxhetit. Pjesa tjetër ka shumë rëndësi se si shpenzohet ai buxhet, ku po e destinon dhe në qfarë forme je duke e destinuar. Mundesh me destinu vetëm në rrugë, mundesh me lënë shëndetsin keq, kanalizimin keq, trotuarin keq, megjithatë kjo është forma me të cilën mundemi me diskutu është forma e shpenzimit. Por që janë shfrytëzu është mirë, mendoj që çdo vit duhet të bëhet përpjekje që buxheti të shpenzohet maksimalisht që neve të mos na ikin mjetet të shkojnë në qeveri.

Drejtor, unë dua t'i ngris disa qështje, shqetësim kam te qertifikatat e lindjes, këtë vit të hyra ka 200, por në vitin 2021 nuk ka asnjë të hyrë. A nuk është nxjerr asnjë qertifikat të lindjes prej qytetarëve në këtë periudhë, seriozisht e don një trajtim të veçantë.

Drejtor, gjobat e inspektoriatit janë të ulëta, unë mendoj që gjobat duhet të rriten ku do që shihet që është duke u shkelur ligji, sepse jemi dëshmitar që çdo ditë e më shumë ka nevojë të bëhen gjoba.

Qiraja prej objekteve, kisha pas dëshirë me ditë cilat objekte komuna i ka në pronësi që janë me qira. Shfrytëzimi i pronës publike, përveq pishinës së Banjës që është në shfrytëzim, për ndonjë tjetër ne nuk jemi të informuar që ka ndonjë pronë në shfrytëzim dhe duhet të vijë në kuvend se cilat prona të tjera mund të jenë në shfrytëzim.

Objektet të cilat janë në ndërtim e sipër duhet të kërkojnë leje, por objektet të cilat janë të përfunduara duhet të kenë legalizim që po duket në këtë vit kemi ngec, apo nuk ka kërkesa për legalizim të objekteve. Te inspektimi higjienik sanitar, këtu është një vlerë mendoj që është e vogël duhet të rritet.

Të hyrat nga agjensioni pyjor, këtu duhet me pas një focus të veçantë, pasi që e kemi dhe drejtorin e bujqësis këtu, këto të hyra duhet të rriten. Pyjet tona janë duke u shkatërruar, duhet të mirren masa shumë të larta kundër atyre të cilët i prejn pyjet ilegalisht. Kalojmë te shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyr analitike Janar-Dhjetor 2022.

Kemi rritje të shpenzimeve udhëtimit brenda vendit, ka një rritje prej 2000.00E. Drejtor, është mirë me na shpjegu.

Akomodim brenda vendit në vitin 2021 nuk ka pas, ndërsa këtë vit 600.00E është shqetësuese sepse Kosovën brenda 1 ore mundesh me vizitu.

Shpenzimet për internet janë të rritura prej 3000.00E. Shpenzime të ndryshme intel, na shpjego pak pse ka një shpenzim kaq të lartë. Shërbimet teknike na duhet një sqarim më i madh se çka janë këto shërbime teknike edhe këtu ka një rritje prej 10,000.00E. Paisje të tjera edhe këtu ka ngritje, por në të njëjtën kohë me na sqaru se qfarë janë paisje të tjera. Furnizim për zyre ka një ngritje këtu, dhe frunizime me dokumente blanko dëshirova me ma deshifru.

Furnizime pastrimi mendoj që si vler është në rregull kështu, por ende është keq mirëmbajtja e pastrimit sidomos në shkolla sepse kemi nxënës aty dhe duhet të mirëmbalhet më shumë higjiëna.

Dru ka një rritje të madhe, përkundër asaj që treguat që ka patur një ngritje për arsye të inflacionit por është një ngritje shumë e madhe krahasuar me vitin 2021.

Karburantet për vetura sigurisht që përveq rritjes së qmimit që ka ndodhë, është mirë me i ndal pak lëvizjet.

Mirëmbajtjen e ndërtesave këtë e kemi kërkuar shpesh herë për cilat ndërtesa bëhet fjalë, sepse dhe këtu e kemi një ngritje një vlerë shumë e madhe.

Te mirëmbajtja rrugore vlera është 42,889.50E a hynë pjesa e dimrit apo mirëmbajtja për gropa. Është mirë me ditë në cilat fshatra ke ndërhy, sepse është vlera shumë e madhe dhe gropat nuk po mbyllen në teren.

Mirëmbajtja rutinore si termë kisha pas dëshir me ditë se qfarë nënkupton.

Drekat zyrtare duhet me i ndal pak sepse prej shumës 9,795.30E e paski ngrit në shumën 20,607.50E. vendimet e gjykatave në këtë rast po e shoh që ka një ramje që është një lajm i mirë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përshëndetje, faleminderit Drejtor për raportin!

Po pajtohna me atë që tha Halili shkalla e suksesit të qeveris matet me shpenzimin e buxhetit, por është me rëndësi dhe struktura e shpenzimit. Unë po ndalna në disa pika të cilat janë shqetësuese për mua, po filloj të zyra e Kryetarit të Komunës kategorit ekonomike, pagat dhe mëditjet janë 36,023.03E dhe mallra dhe shërbime janë 7,750.00E. te subvencionet është 65,000.00E, kur na e dimë që në kuvend në çdo seancë kemi kërkesa prej qytetarëve nëse kësaj ja shtojmë që Kryetari pa e sjellë në kuvend nuk mundet me ndihmu askënd mbi shumën 500E i bie që i ka subvencionu 130 raste.

Drejtorja e shërbimeve publike kategoria e pagave dhe mëditje 183,733.86E, mallra dhe shërbime 144,945.00E, pra pjesmarrja e kategoris së mallrave dhe shërbimeve është 78%.

Zyra lokale e komuniteteve e dimë që është një zyrtar për komunitete në kategorin e pagave i ka 6,042.36E, ndërsa në kategorin e mallrave dhe shërbimeve i ka 5,799.00E që në përqindje është 95.9%.

Zyra e kuvendit kategorin e pagave dhe mëditje i ka 97,281.19E ndërsa kategoria e mallrave dhe shërbimeve i ka 46,500.00E pra në total pjesmarrja e kësaj kategorie është 47.7% ku ne shpesh herë po ballafaqohemi me munges të mjeteve dhe materialit të domosdoshëm.

Drejtorja për administratës kategorin e pagave e ka 297, 215.39E, ndërsa kategorin e mallrave dhe shërbimeve e ka 274,904.00E i bie 92.4% është kategoria e mallrave dhe shërbimeve është shumë.

Zyra për barazi gjinore kategorin e pagave e ka 6,701.46E, ndërsa kategoria për mallra dhe shërbime është 6,200.00E. Kam parë te drejtorit përkatëse projekte të cilat për fat të keq qe 5 ose 6 vite figurojn dhe nuk gjejnë zbatim.

I kam disa pyetje për Drejtorët është fjala për Drejtorin për Kulturë në aspektin e trashëgimisë ne i kemi pasur disa projekte të cilat nuk e dimë a kanë fillu procedurat apo jo. Qe disa herë barten projektet e njëjta është fjala për ndërtimin e kullës Tahir Berisha në Kijevë.

Pastaj Drejtorja e Arsimit që është shqetësim, kategorin e pagave dhe mëditjeve e ka 6,798,786.15E, ndërsa kategorin e mallrave dhe shërbimeve e ka 604,953.72E që në pjesmarrje i bie 11%. Kjo për mua është mjaftueshëm tregues se qfarë gjendje kemi në shkolla.

Te shpenzimet analitike u cekën udhëtimet zyrtare prej 1,044.00E. janë rrit në 3,033.00E.

Shërbimet kontraktuese tjera është mirë me i specifiku se qka janë këto?

Mirëmbajtja e ndërtesave prej 65,582.67E është ngrit në 197,918.87E.

Shërbime intelektuale prej 9,580.00E në 35,680.00E. Drekat zyrtare e cekën dhe kolegët, një qeveri e mirë duhet me shpenzu parën aty ku duhet dhe me kursy aty ku është mundësia me kursy. Në ekonomi duhet me bërë përjekje që shpenzimet të cilat i konsiderojmë të lluksit me u ulë sa më shumë, ose me i minimizu sa më shumë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Përshëndetje të gjithë!

Deshta me ja bërë një pyetje Labit, se si i ka llogarit këto përqindje se nuk e kuptova?

Dhe një pyetje tjetër për drejtorin e financave, te pjesa e investimeve kapitale ku kjo është njëra prej kategorive ekonomike e cila ndikon direkt te qytetarët, por ndikimi me i madhë në atë aspektin e

zhvillimit ekonomik. Ne e kemi marrë një vendim për ridestininim të mjeteve të disa projekte për disa projekte të tjera. Mirëpo në raport financiar nuk l pashë që ato vlera kanë ndryshu apo që janë bartë nga projekti që ne kemi kërkuar të barten. Ka ndodhë ndonjë gabim teknik apo si ka rrjedhë kjo?

Sa i përket shpenzimit të buxhetit ne ju përgëzojmë, sepse shpenzimi i buxhetit nuk vjen rastësisht por vjen për shkak të angazhimeve dhe punëve gjatë një viti.

Te hyrat po ashtu patë një rritje, rreth 88% është realizu plani i te hyrave vetanake, ndërsa pjesa tjetër ka ardhë si rezultat i detyrave nga gjykata dhe gjobat në trafik. Patjetër që këto të hyra i kanë ndihmu qeverisjes për përfundimin e disa projekteve.

Argjend Thaçi: Urdhëro Bledar Kryeziu!

Bledar Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë!

Po ndalna vetëm të një kategori, për mobilje në vitin 2022 janë ble 22,857.00E, kurse të mirëmbajtja e mobilieve dhe paisjeve prej 4,802.00E në 79,367.96E ku me përqindje është 1,556% në rritje. Ku shihet gjendja këtu, që prej që e kemi marrë mandatin karriga është e prishur.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaqi: Vetë realizimi i shkallës së lartë të shpenzimeve rrit dhe krahasimin dhe diferencën me vitin e kaluar. Po ndalemi të të hyrat vetanake në mënyrë analitike të cilat i ceket. Valoni që e cekim nga të hyrat e planifikuara të rregullta sillet rreth 88%, por në planifikim të të hyrave, bëjnë pjesë dhe të hyrat nga gjobat në trafik dhe vendimet gjyqësore, si total i të hyrave jo vetëm të rregulltave. Te qështja e qertifikatave është kodi për të cilat paguhen shërbimet për qertifikatat e lindjes dhe qertifikatat e tjera, e cekim dhe Valoni që disa shërbime kryhen dhe me kode të tjera, dhe mund të themi që nuk është vlera e qertifikatave 200E.

Gjobat nga inspektoriat pajtohen me juve që janë pakë, por nëse e krahasojmë me vitin e kaluar e cila ka qenë 610.24E, është më e lartë në këtë vit. Te objektet me qera dhe shfrytëzimi i pronës publike, pyetjen që e bëre Nebih se cilat janë ato vendime të cilat janë dhënë jashtë asambles për shfrytëzim të pronës publike ju e dini rastin në Mirushë që është dhënë prona në shfrytëzim për qështjen e operatorit me gazë, pra ka obligime që kryhen ndërtimet e mëhershme dhe kryhen shërbimet.

Te taksat për parking publik, kampim, rekreacion nuk mundem me thënë saktë, por është një qështje që mund të jepet një hapsir publike për shfrytëzim një orë apo dy për rekreacion siç janë dhe lojrat, ai paguan një taks për shërbim.

Licecat tjera i kemi cekë dhe në KPF-ë, është qështje se a kërkojnë licencim afarist.

Taks për legalizim të mjeteve, e kemi cekur dhe në KPF-ë është një qështje që ose kanë përfunduar legalizimi sipas ligjit që ka qenë ose nuk ka kërkes. Këtu bëhet fjalë për objektet të cilat janë ndërtuar më herët.

Inspektimi higjienik pajtohem me ju, por është një ngritje e vogël 150E, të kishte qenë një inspektim më i madh dhe të bëhet gjobitja e subjekteve afariste të cilat nuk i kanë kushtet higjienike, sanitare të mira sidomos në gastronomi kjo është qështje e inspektoriatit.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike. Ta keni parasysh se në vitin 2022 i kemi përfunduar dhe obligimet e vitit 2021, dhe kjo nuk do të thotë që shpenzimi në një kategori është përfunduar vetëm në vitin 2022. Marrim shembull shërbimet e furnizimit me dru, kemi pasur obligime të vitit 2021. Përse është rrit qmimi dhe shpenzimi të kategoria për dru, kategori të veçant të mallra dhe shërbimet për pelet nuk shënon, peleti dhe drut janë me një kod për këtë arsye ka këtë ngritje.

E cekim kategorin e antarsimit kemi obligime për asociacionin për Komunë të cilat nuk kanë përfunduar dhe janë grumbulluar 41,000.00E, dhe tani nëse ne e bëjmë shpenzimin total për 4 ose 5 vite të cilat nuk janë paguar nuk do të thotë që shpenzimi është vetëm 1 vitit 2022. Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit në këtë pjesë hynë dhe transporti të cilat u bënë për vzita të varrezat e Kleqkës, Dëshmorëve, Prekaz, dhe organizimet e tjera të cilat u bënë për pensionist dhe veteran. Në vitin 2021 nuk ka pasur lëvizje për arsye të pandemis. Kemi pasur një festival dhe kemi pasur mysafir nga qeveria dhe i është siguruar akomodimi, kanë pasur qëndrim tre ditë. Shpenzimet e internetit janë rrit për arsye të inflacionit. Shërbimet e

ndryshme intelektuale në vitin 2022 ka pasur konkurse të shumta në administratë dhe duhet të ketë një anëtar Komisioni nga jashtë. Kemi komisione të ndryshme që kërkojnë anëtar nga jashtë.

Kompjuterët, një prej shpenzimeve për kompjuter është shërbimi i juaj me Laptop. Furnizime zyre janë furnizime të nevojshme për zyre është një ngritje por janë të zakonshme këto shërbime. Furnizim me dokumente blanko është furnizimi me material për qertifikata, administratë.

Furnizim pastrimi sigurisht që kemi mirëmbajtjen e objekteve siç është Komuna dhe objektet e tjera është rrit vlera, sepse është rrit dhe shërbimi por njëkohësisht është dhe pjesa e obligimeve që kanë qenë në vitet paraprake. Te qështja e mirëmbajtjes së mobiljeve janë furnizimi zyret e Komunës me mobilje, për këtë arsye ka pasur shpenzim më të madh. Është e nevojshme dhe rregullimi i asambles komunale dhe shpresojmë që do të bëhet dhe një gjë e tillë.

Dreka zyrtare këtu ka pasur aktivitete solemne apo raste të festive siq janë Marsi, Shkurti, Qershori dhe Nëntori viti paraprak nuk ka pasur aktivitete për arsye të pandemis.

Te kategoria e subvencioneve realizimi i shpenzimit në zyren e Kryetarit nuk janë të gjitha të cilat i ka shpenzuar Kryetari, sepse dhe vendimet e juaja janë paguar nga zyra e Kryetarit.

Te pagat dhe mëditja nuk mundem me bërë krahasimin e pagave dhe mëditje me mallra dhe shërbime në arsim, sepse në arsim ka punëtor më shumë. Kanë nevojë shkollat për mirëmbajtje.

Labinot, t'i e cekë një herë që puna për kanalizime dhe trotuare figuron që kanë përfundura, por nuk janë përfunduar. Por në fshatin Kijevë nuk është përfunduar në fshatrat tjera ka përfunduar vetëm në fshatin Kijevë jo. Unë pajtohna që është dashur dhe te ju me u përfunduar. Ne duhet me shenu sepse operatori paguhet për të gjitha punët të cilat përfundohen sepse ai në fund e sjell fakturën për punët të cilat i ka bërë, dhe ne nuk mundemi me cekë që vetëm fshati Kijevë nuk është përfunduar.

Qështja e ndriqimit e shpjegoj dhe Kryetari siq është duke shkuar aktualisht realizimi i shpenzimit dhe kosto e shpenzimit të energjisë më mirë të kishte qenë kovalent.

Labinot Gashi: Është e vërtet që është ngrit qmimi i energjisë, por prapë figuron në projekt mirëmbajtja e ndriqimit publik në vlerë prej 60.000.00E, edhe ato rrugë të cilat kanë ndriqim nuk funksionojnë. Ka rrugë të cilat janë të buxhetuara, por nuk kanë ndriqim publik fare.

Blerim Thaçi: Labionot, sipas informacioneve të cilat i kam te pjesa Bubavec-Balincë po kemi probleme me ndriqimin publik për arsye se ka defekte të ndryshme, mirëpo është qështje e urbanizmit. Unë i ekzekutoj pagesat në bazë të raporteve të cilat i sjellin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Bledar Kryeziu!

Bledar Kryeziu: U cekë nga kolegët mirëmbajtja e ndërtesave por a mundesh me na sqaru më mire, sepse në vitin 2021 ka pasur më shumë shpenzime sepse ka qenë virusi, ndërsa tani është një rritje më e madhe me vlerën prej 197,918.87E.

Blerim Thaçi: Nuk duhet me bërë krahasimin në këtë formë, sepse në vitin e kaluar ka pasur dhe shërbime edhe nga niveli qendror. Ka pasur dhe pauza, tani e dini që është rrit dhe shërbimi për arsye të inflacionit.

Argjend Thaçi: Faleminderit Drejtor për përgjigjet e pyetjeve të cilat u bënë, diskutim për këtë pikë nuk ka, po e mbylli këtë diskutim për këtë pikë të rendit të ditës për të vazhduar me pikën e radhës mbas pauzës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transportin publik urban, te kjo pikë nuk kemi përfaqësues nga Drejtoria dhe as një anëtar nga Komisioni për ta prezantuar të cilët e kanë hartuar këtë Draft-Rregullore.

Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Drejtori ma dërgoj një mesazh, që për arsye të një takimi zyrtar që kanë në Prishtinë, nëse mundeni me kalu në pikat e radhës, ndoshta mundet me mbërri në scancë më vonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Unë mendoj që nëse nuk është Drejtor ose ndonjë anëtar i Komisionit është mirë me ju shty për arsye se nuk dimë kujt me ju drejtu kur kemi pyetje. Ne si grup jemi për me shty.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne e kemi shtjerrë debatin për këtë pikë në seancën e kaluar, ne përveq të disa vrejtimeve të cilat i kemi pasur në aspektin teknik të formulimit në përmbajtje dhe në esencë jemi pajtuar pajtuar me atë rregullore. Nuk kisha thënë me u shty pasi që i kemi përfunduar gati të gjitha procedurat mos të i bartim. Unë kërkoj që ta trajtojmë dhe ta votojmë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina: Edhe ne jemi që kjo pikë e rendit të ditës të vazhdojë dhe jo të largohet nga rendi i ditës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Sa i përket kësaj pike dhe unë isha së bashku me Valonin kur Drejtori kërkoj mirëkuptim me kalu në pika të tjera për arsye të takimit zyrtar. Unë mendoj se pa qenë drejtori këtu nuk ka kuptim me i dhënë shqyrtim apo diçka tjetër. Unë mendoj të shtyhet nëse vjen Drejtori gjatë seancës, nëse jo të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim propozimin e Nebihit, kush është për që kjo pikë të shtyhet?

Për: 9

Kundër: 12

Abstenim: 0

Me 9-Për, 12-Kundër, 0-Abstenim mbetet kjo pikë në rend të ditës.

E hedhi në votim kush është për miratimin e kësaj Rregullore?

Për- 12

Kundër- 8

Abstenim- 2

Me 12-Për, 8- Kundër, 2- Abstenime, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2023. Për ta prezantuar këtë pikë e kemi kordinatorin e këtij këshilli z. Halit Mazreku.

Halit Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Këshilli komunal për siguri në bashkëpunim me policinë e Kosovës, analizon dhe shqyrton të gjitha qështjet e sigurisë në bashkëpunim me policinë e Kosovës, analizon dhe shqyrton të gjitha qështjet e sigurisë së komitetit për të mirën e të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunën e Malishevës, me qëllim të ngritjes së vetëdijës, për lloje të ndryshme të dukurive negative, prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal, si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike, bazuar në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012MPB-03/2012 MAPL. Këshilli komunal për siguri në Bashkësi ka për qëllim rritjen e vetëdijimit të qytetarëve ligjur me dukurit negative, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave lidhur me sigurin publike dhe rekomandimin e planeve të veprimit për ti adresuar këto brenga në bashkëpunim me autoritetet komunale, komunitetet lokale dhe policinë e Kosovës.

Sipas Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, dhe vendimit të Kuvendit të komunës së Malishevës nr.02/32 të datës:28.01.2020, është themeluar KKSB dhe përmes të cilave dhe janë përcaktuar dy pika, përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësit dhe funksionimi i KKSB.

Argjend Thaçi: A keni diqka që të shtoni rreth këtij Planit të punës të KKSBB?

Nëse nuk ka diskutues, shkojmë në votim. Kush është për?

Me vota unanime, kjo pikë kalon.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të luftës për vitin 2023. E kemi anëtarin e këtij komiteti urdhëro Eqrem!

Eqrem Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Ky komitet është themeluar nga Asambleja Komunale e Malishevës, me qëllim ruajtjen dhe respektimin e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Plan i veprimit do të jetë Platforma e Komitetit, i cili duhet të përmbushet në përpikmëri në fazën e caktuar kohore. Ky Plan i ka të përfshira Objektivat, aktivitetet, treguesit e verifikueshëm, rreziqet dhe supozimet, koha e implementimit të objektivit si dhe Komentet. Komiteti duhet të ngrejë qështje përkitazi me vlerat e luftës..komiteti duhet të jetë pjesmarrës drejtpërdrejtë në akademit përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve të luftës së UÇK-së të komunës së Malishevës. Një anëtarë i Komitetit të përfaqësohet në Këshillin Organizativ për shënimin e Akademisë përkujtimore apo të një organizimi të ngjajshëm.. Komiteti duhet të jetë pjesë e organizimit të festive me karakter kombëtar siç janë: 17 shkurti, 5-7 marsi (Epopëja e UÇK-së), 16 Qeshori, 28 nëntori, 30 vjetori dhe 28 prilli 1998 beteja e parë e Balincës. Një anëtarë i Komitetit të përfaqësohet në Këshillin Organizativ për shënimin e Akademisë përkujtimore apo të një organizimi të ngjajshëm.. Komiteti në Planin e vet parasheh dhe realizimin e botimit të një reviste vjetore. Të gjitha aktivitetet janë të përfshira në Plan të punës dhe kërkoj mbështetje nga ju.

Argjend Thaçi: Faleminderit Eqrem, a ka dikush të shtojë për Planin e Punës së këtij komiteti? Atëherë, kush është për miratimin e planit të këtij Komiteti? Me vota

unanime, kalon kjo pikë.

Kalojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/11 datë: 10.01.2022, e parashtruar nga Jetmire Vrenezi dhe Gani Krasniqi, Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë kërkesë bëhet fjalë për një zyre në të cilën të kenë mundësi të kenë kontakte me qytetarë të komunës së Malisheës. Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Sa i përket kësaj kërkesë, unë e di që është një kërkesë që disa kohë, dhe lidhje me këtë kërkesë deputetët e parlamentit të Kosovës përveq qështjeve tjera qështja me rëndësi e tyre është ngritja e shqetësimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës, respektivisht prej ati lokaliteti prej nga vjen. Deputetët e nderuar të cilët e kanë bërë këtë kërkesë në dy vjet mandate, unë nuk e di kur e kanë shtuar ndonjë projekt të Komunës së Malishevës, madje nuk e di që ndonjëherë e kanë cekë ndonjë shqetësim për qytetarët e Komunës së Malishevës. Ka qenë gjendje e tmerrshme me furnizim të energjisë elektrike, unë nuk kam parë asnjë deklaratë nga foltoret e parlamentit nga ata deputet të nderuar që të ngrisin shqetësime rreth kësaj. Përse unë jam kundër kësaj kërkesë, për arsye se veprat ndërsohen sipas qëllimit përse duhet me u bërë, dhe unë po e shoh që këtu qëllimi është përfundim politik dhe jo qëllim i interesave të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Sa i përket kërkesës së deputetëve, këta janë bazuar dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin që i përcakton detyrat, obligimet dhe përgjegjësit, por dhe të drejtat e deputetëve të kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast ne si asambleist duhet me vlerësu këtë kërkesë për zyre, për arsye se në aspektin e hirarkisë ata kanë kërkuar nga ne dhe pse ata janë deputet të parlamentit. Ata kanë kërkuar me pas një bashkëpunim të ndërsjelltë jo vetëm me qytetarë, por dhe me kryetarin e Komunës Kastrati dhe me secilin Drejtor të përkatës. Sa i përket qështjes tjetër se kush jemi ne ta konstatojmë një veprimtari psh. Gani Krasniqi, unë mendoj që ne duhet të lexojmë më shumë për veprimtarin e tyre, sepse pak rëndësi ka se si do të votojmë ne këtu a do të votojmë për një zyre apo për një objekt që ata ta shfrytëzojnë institucionin Komunal apo jo. Mendoj që Gania është vlerësu për qfarëdo pozite që ka qenë, qdo herë ka qenë zë i qytetarëve si para lufte dhe mbas lufte.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Secili qytetarë i kësaj komune ka të drejtë me bërë kërkesa në këtë kuvend. Sa është legjitime kërkesa? Kërkesa është legjitime sa ka kuptim dhe sa ka seriozitet, kjo kërkesë për mu nuk ka aspak seriozitet.

Halili, e cekti një gjë që e kisha për qëllim ta cekti dhe unë, në kërkesë ceket kjo zyre në radhë të parë ju detyrohemi atyre që na besuan përmes votës së tyre, kush ja ka dhënë votën atyre vetëm VV-ja, pra kjo po i bie që ka me qenë zyre e VV-së. Qështja tjetër ndoshta mbi 2000.00E kta e marrin pagën mujore, e qka është për ta me bërë një zyre këtu afër Komunës dhe me qenë afër qytetarëve.. E njohim Ganin e njohim dhe Jetmiren, Valon ndoshta ti ke nevoj me lexu për ata, sepse ne i njohim personalisht. Respekt për punën e tyre, si grup i Nismës e dha Halili verzionin si shef dhe unë e përkrahi, mirëpo Muharremi është më gjatë se ne këtu. Kta janë thirr në Kushtetuten e Kosovës dhe ligjet në fuqi që duhet me ju nda zyren por e kanë gabim sepse në Kushtetuten e Kosovës nuk shënon që Kryetari duhet me ja nda një zyre Deputetit të Kuvendit kjo nuk ka logjikë.

Kryesus, janë disa kërkesa të cilat janë duke prit me u sjell në kuvend e që nuk kanë mundur me ardhë në Kuvend për arsye të agjendes së ngarkuar në Kuvend, po na sjellni kërkesa që për mendimin tim është turp me kërkuar zyre të punës nga Kryetari, me lënë një degaster të caktuar pa zyre, për me ja dhënë dikujt që me 200E munden me marrë një zyre me qira.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka dikush tjetër për diskutim e hedhim në votim kërkesën nr.02/11 datë: 10.01.2022, kush është për?

Për: 2

Kundër: 12

Abstenim: 10

Me 2 vota për, 12- Kundër, 10-abstenim, nuk kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e radhës e cila është: Shfuqizimi i vendimit nr.02/71 datë:07.02.2023, për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja. Është ardhë një vendim jo i qartë që ka të bëjë me formimin e Komisionit të cilin e kemi bërë. Këtu ceket që Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapsinor Mapl-ja që ju ka dërguar kësaj ministrie nuk është kompetente për shqyrtimin e këtij akti Komunal pasi që dispozitat e ligjit nr 04/L-013 për kadastër: Ligji mbi ndryshimet e plotësimit të ligjit nr 2002/5 mbi themelimin e regjistrit të të Drejtave në pronën e pa luajtshme, dhe ligji 04/L-071 për systemin e adresave nuk e parashohin formimin e komisionit të tillë. Ndërsa ka komuna të cilat e kanë formuar këtë komision. Urdhëro, Halil Morina

Halil Morina: Kjo përgjigjie të cilën e ka kthyer MAPL-ja, është shumë e pa qartë dhe është e dykuptimtë. Kjo nuk është arsye për me anulë në një vendim. Nëse ligji nuk e parashih mu kriju një Komision i tillë a din kush me na tregu se kush ju ngjet emrat e rrugëve të reja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Unë bisedova dhe me Muharremin, këtë qështje sipas ligjit është në rregull që ti mos me mujt me formu këtë Komision. Por duhet me komunikë me ministri të linjes si mirren ata emra nga ajo listë, në qfarë forme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Edhe vetë e kam parë shkresën të cilën e ka përcjell ministria, një dozë të së drejtës ja kisha dhënë për faktin se ka thënë referoju listës rezerv. Lista rezerv i ka emrat të cilët i ka përcaktu, apo i ka përzgjedh kuvendi. Te ajo listë rezerv është një zyrtar i drejtorisë së urbanizmit i cili ka mi sistemë emrat në sistem. Dhe të gjitha kërkesat e reja të cilat vinë për emërtimin e rrugëve të reja duhet me shku te drejtoria e urbanizmit, përkatësisht te ai zyrtari i cili i fut këto të dhëna në sistem dhe e posedon listën e emrave rezerv. Ata të cilët kanë kërkesa ju ofrohet lista, dhe ja tregon që këta janë emrat të cilët i posedojmë për të cilën mund të ja vendosim rrugëve të reja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Sa i përket kësaj qësjhtë nëse komisioni i vitit të kaluar ka dhënë opsione me emra rezervë, dhe Komisioni nëse formohet i ri prap se prap nuk mundet me i anashkalu këta emra rezervë dhe me shku me emra të rinjë. Edhe unë po pajtohna që nëse Drejtoria ka emra rezervë nëse ka ndonjë kërkes nga qytetarët atëher le të ju prezantohen ata emra.

Argjend Thaçi: Urdhëro Muharrem Morina!

Muharrem Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Kryesusi e dinë që hale pa e fut si qësjhtë në debat i kam thënë mos me shti, sepse nuk kalon, përarsye se është procedura siq e shpjegoj dhe Valoni. Në mandatin e kaluar Halili ka qenë, ka pas dhe anëtar të tjerë që ky Kuvend i ka miratu emërtimet e rrugëve pastaj është bërë dhe një listë rezerv. Nuk duhet dhe një Komision tjetër për me i bërë këta emra, vetëm duhet banorët e asaj rruge që mendojn me ndryshu emrin duhet me qenë të një pajtimi. Në listën rezerv ka emra të Dëshmorëve, ka emra të ndryshëm, dhe banorët të lokalitetit duhet me u pajtu një her mes vete për një emër dhe pastaj me sjell atë emër prej listës rezerv në Drejtorin e urbanizmit dhe ai emër vendoset. Ka qenë koha e debatit kur fshati ka mundur me i përcaktu emrat që mendon me i pas në fshat të vetin edhe nëse nuk ka kalu në hapin e parë në listën me emra të rregullt, ka mundur me hyrë në listën me emrat rezervë. Është një koh ligjore që duhet me kalu ai afat dhe mbasi të kalon ai afat hapet rruga për emra të rinjë.

Argjend Thaçi: Fillimisht duhet të i përgjigjem ministris, konform asaj me ligj që e kemi me shfuqizu dhe tani nëse ndryshon ndonjë gjë nuk e kemi të pamundur me formu komision tjetër. Kush është për shfuqizimin e vendimit nr. 02/71 datë:07.02.2023, për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja?

Me vota unanime, shfuqizohet ky vendim.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/425 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës së Malishevës. Bëhet fjalë i cili ka pas një dëmtim apo djegie të shtallës. Kemi drejtorin e bujqësis nëse mundet me na ndihmu në këtë Drejtim. Urdhëro, Sylë Dukolli.

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë!

Kemi një dëmtim të stallës dhe ne si drejtori e bujqësis, ju si përfaqësues të popullit e di që dëshironi me ju ndihmu secilës kategori e cila dëmtohet në këtë rast. Keni me pas dhe kërkesa të tjera prej Drejtoris së Bujqësis dhe dua të ju njoftoj se prej që kam ardhë një stall nga fshati Lubizhdë tashmë nuk ekziston për arsye të një sëmundje të izoluar dhe ende nuk ka dalë këtu si kërkes. Kryesus po të tregoj se ajo kërkes është bërë qe 4 ose 5 muaj nga Lutfi Paqarizi dhe kisha kërkuar që në muajin e ardhshëm përmes KPF-së të sjellet në Kuvend. Është ferma më serioze që kam gjetur kur kam ardhur në Komunën e Malishevës e them këtë me përgjegjësi, fati ka qenë i tillë dhe ajo fermë nuk ekziston më është mirë që të i ndihmojmë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Nuk ka dyshime që na jemi për me i ndihmu çdo kujt që ka pasur fatëkeqësi natyrore, në rastin konkret unë nuk jam i sigurt dhe nuk kam informacion a është dëmtuar tash së fundmi apo është e dëmtuar më herët. Qfarë lloj aktiviteti blejtoron në atë shtall. Me që neve na ka ardhë si kërkes nga KPF unë propozoj të i ndahet shuma 1000.00E.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Edhe unë pajtogem me Sylën që disa kërkesa ndoshta po neglizhohen, mirë është që ato qka janë me i sjell me rend qka janë me urgjenc, e di që janë shumë kërkesa por me i përzgjedh ato në shkalla më të rënda, sepse edhe si buxhet dhe si komun është e pa përbalueshme me i ndihmu secilit për nevojat që i ka. Po pajtoj me Halilin që kësaj kërkesë të i ndahen 1000.00E.

Argjend Thaçi: Kush është që kërkesës nr.01/425 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës së Malishevës të i ndahet shuma 1000.00E?
Me vota unanime aprovohet kjo kërkesë.

Konstatohet që të pranishëm jemi 23 anëtar të kuvendit që do të thotë kemi korum dhe mundemi me vazhdu seancën.

Kalojmë në pikën tjetër e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/81 datë:10.02.2023. kërkesë e parashtruar nga Isuf Ulluri këto kërkesa i kemi të kategoris së njëjt me Kancer. Një gjë duhet me pas parasysh që nuk mundemi njëren me kalu tjetrën me shty sepse janë të njëjtës kategori. Urdhëro Halil!

Halil Morina: Për çdo seancë ne kemi kërkesa të llojit të tilla dhe është edhe më e dhimbshme kur shohim fëmijë. Ka shumë kërkesa të tilla që kapacitetet tona janë të pamundura me i mbulu, ne zakonisht e kemi pas bërë një standart në vlerë prej 2000.00E për secilën. Unë kisha thënë me shku me 1500.00E dhe të shkojmë ta ulim në muajt e ardhëshëm. Unë propozoj që të gjitha ato kërkesa meqë janë të natyrës së njëjt të ja ndajmë një shumë prej 1500.00E.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati Sigurisht dhe ne pajtohemi me atë vlerë që e propozojë Halil Morina, 1500.00E.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim kërkesën nr. 02/81 datë:10.02.2023. Kush është që kësaj kërkesë për ndihmë financiare të i ndahen mjetet 1500.00E?

Unanimisht aprovohet kjo kërkesë.

Kërkesën e radhës e kemi: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/09 datë: 06.02.2023. e parashtruar nga Shukrie Gashi, Kush është që kësaj kërkesë për ndihmë financiare të i ndahen mjetet 1500.00E.

Unanimisht, aprovohet kjo kërkesë.

Kërkesa e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/35 datë: 19.01.2023. Nga Rrahime Kryeziu, Kush është që kësaj kërkesë për ndihmë financiare të i ndahen mjetet 1500.00E.

Unanimisht aprovohet kjo kërkesë.

Kemi kërkesën e fundit e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/20 datë:11.01.2023. Kush është që kësaj kërkesë për ndihmë financiare të i ndahen mjetet 1500.00E.

Unanimisht, aprovohet kjo kërkesë.

Kalojmë te pika tjetër që është zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Urbanizëm, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor.

Urdhëro Arlind!

Arlind Morina: Unë propozoj që në vend të Skender Rrahmanaj të futet Arbër Kastrati.

Argjend Thaçi: Kush është që të bëhet zëvendësimi i anëtarit Skender Rrahmanaj me Arbër Kastrati.
Për: 21

Kundër: 2

Abstenim: 0

Me 21 vota për, 2- kundër, 0-abstenim, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e fundit është zëvendësimi i anëtarit të Komitetit të Diasporës. Urdhëro, Arbnore!

Arbnore Hoti: Në vend të Arbër Kastrati të jetë Valon Krasniqi.

Argjend Thaçi: Kush është që në vend të Arbër Kastrati të jetë Valon Krasniqi anëtar i Komisionit për Diasporë?

Me 19 vota për, 2- kundër, 2 - abstenim, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Të ndryshme.

Urdhëro Nebih!


Nebih Bibaj: I ftoj të gjitha grupet parlamentare të cilat janë këtu ta bëjmë një fotografi të përbashkët para fotores me qëllim të vetëm për marshin për Drejtësi e cila do të mbahet me datën 02.04.2023. do të mbahet për ata burra që po mbahen në hagu padrejtësisht. Kjo nuk ka të bëjë me politik, në kësi lloj raste kemi qenë të gjithë së bashku.

Argjend Thaçi: A ka dikush tjetër te të ndryshmet?
Përveq kësaj ju ftoj që neser të jeni prezent në mbledhjen përkujtimore, e cila do të mbahet për Masakren e Burimit. Ju falenderoj dhe këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Përfundoi në ora: 14:35

Procesmbajtësja:

Argenitë Krasniqi



Kryesuesi i Komitetit

